



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 101/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 03.06.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, nën "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 18, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren së QRK, Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 19, paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **03 qershor 2024**, merr këtë:

### VENDIM

### PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR SHQYRTIM TË ANKESAVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit;
- 1.2 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit;
- 1.3 Maliq Ferizi, anëtar i ekzekutivit;
- 1.4 Hyra Hoxha-Uka, anëtare e ekzekutivit;
- 1.5 Blerim Ibrahim, anëtar i shoqërisë civile.

2. Mandati i komisionit është dyvjeçarë, brenda mandatit të tanishëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

3. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin kryesuesin e komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

4. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores së QRK, Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e komisionit të cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit